

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.ANr. 254 Prot.Tiranë, më 03/11 /2022

Lënda: Propozim për miratimin e rregullit të përcaktimit të Urdhërporosive fituese në rastin kur një segment i grupuar i Urdhërporosive Shitjeje/Blerjeje do të pranohet pjesërisht sipas parashikimeve të seksionit B.2.1 të Procedurës së Tregtimit.

Drejtuar: **Entit Rregullator të Energjisë**
Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, Nr. 1023, Tiranë.

I nderuar z. Ahmeti,

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarra, tashmë në cilësinë e të licencuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022, duke pasur parasysh rolet dhe përgjegjësitë e këtij funksioni është duke punuar për të propozuar pranë Entit Rregullator të Energjisë plotësimin e kuadrit të nevojshëm rregullator në lidhje me aktivitetin e saj.

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana e ALPEX-it për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të ALPEX, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, paraqet para Jush propozimin për miratimin e rregullit të përcaktimit të Urdhërporosive fituese në rastin kur një segment i grupuar i Urdhërporosive Shitjeje/Blerjeje do të pranohet pjesërisht sipas parashikimeve të seksionit B.2.1 të Procedurës së Tregtimit.

Ky propozim është hartuar duke marrë në konsideratë plotësimin e parashikimeve të Procedurës së Tregtimit të ALPEX sh.a, e cila është dërguar pranë jush me anë të shkresës Nr.201 Prot. datë 29.08.2022 për miratim. Kjo Procedurë në seksionin B.1.2 “Përcaktimi i Çmimeve dhe Sasive të Ankandit” të saj, parashikon rastet kur një segment i grupuar i Urdhërporosive Shitjeje/Blerjeje me çmimin e saj të barabartë me Çmimin Klerues do të pranohet pjesërisht për shkak se është në pikë-prerjen e kurbave të grupuara të blerjes dhe shitjes.

Ky rast nënkupton që në këtë segment të grupuar mund të jenë disa Urdhërporosi të cilat kanë të njëjtin çmim të ofertuar, por që sasia e energjisë elektrike përkatëse e ofertuar është më e madhe se sa sasia e pranuar nga ankandi për këtë segment për të gjitha këto Urdhërporosi. Në këto kushte del e nevojshme të miratohet rregulli i përcaktimit të fituesit/eve.

Për sa më sipër, nisur edhe nga eksperiencat evropiane kemi vlerësuar që në këto raste parimi i përcaktimit të fituesit/eve të jetë ai i “kush vjen i pari do të shërbehet i pari” (first come, first

serve) pra, Urdhërporositë Shitjeje/Blerjeje fituese sipas radhës do të jenë ato të cilat kanë qenë të vendosura në ETSS me herët, gjë që identifikohet nëpërmjet gjurmës së kohës (timestamp) dhe trajtohet sipas këtij parimi. Pra, në fillim plotësohet sasia e energjisë që i përket Urdhërporosisë më të hershme të vendosur në ETSS, e cila mund të jetë e plotë ose e pjesshme. Pasi plotësohet sasia e energjisë së urdhërporosisë më të hershme vijohet me plotësimin e sasisë së energjisë së Urdhërporosisë së dytë më të hershme të vendosur në ETSS, e cila mund të jetë e plotë ose e pjesshme. Ky rregull vazhdon deri në ezaurimin e plotë të sasisë së energjisë të këtij segmenti të pranuar nga ankandi.

Duke marrë parasysh nevojën për një treg të drejtë dhe pa probleme në formimin e rregullt të kontratave, referuar praktikave të ndjekura nga Bursat e Energjisë të vendeve Evropiane, si dhe referuar procedurës së ndjekur nga Ofruesi i Shërbimit (Henex), për vendosjen e parimit “kush vjen i pari do të shërbehet i pari” (first come first serve), Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a propozon si vijon:

1. Miratimin nga ana Juaj të parimit rregullit “kush vjen i pari do të shërbehet i pari” (first come first serve), në përcaktimin të fituesit/eve në rastin kur një segment i grupuar i Urdhërporosive Shitjeje/Blerjeje do të pranohet pjesërisht për tregtim me transparencë dhe të drejtë në Bursën e Energjisë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a

Sokol Dishnica

